

# **AKT-THEMELIM DHESTATUTI**

## **I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

P S Sh.p.k.

Neni 1

### **THEMELIMI I SHOQERISE**

Sot md dt. 01 Gusht 2022, bazuar ne kerkesat e Ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare " ( i ndryshuar ), me vullnetin tone te lire ( sot e ne vazhdim Ortak Themelues), une, Perparim i idendifikuar me karte id me nr. H60127093I i dt.lindje 27.01.1976; vendosa te krijtoj Shoqerine me pergjegjesi te kufizuar P S Sh.p.k.

Aktiviteti baze i kesaj shoqerie rregullohet me ane te ketij Statuti.

Shoqeria vepron ne perputhje me Ligjin 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare" ( i ndryshuar) , me ligjin 9723 data 03.05.2007, per Qendren Kombetare te Biznesit, ( te ndryshuar) e te tjera ligje ne fuqi te legjislacionit shqipfitar.

Shoqeria do te kete vulen e saj ku do te shkruhet emeri tregtar dhe nipti.

Neni 2

### **EMERTIMI**

Emertimi tregtar eshte P S Sh.p.k.

Neni 3

### **SELIA**

Selia e shoqerise do te jete ne adresen; Lezhe , Njesia Administrative Milot, Zona kadastrale 1677, me numer pasutie 110/15, Fushe Milot.

Shoqeria P S Sh.p.k. ka te drejte te hape zyra, perfaqesi e filiale ne rrethe te tjera te vendit dhe jashte Shqiperise.

Neni 4

### **KOHEZGJATJA**

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike te shoqerise P S Sh.p.k. eshte pa afat.

Afati mund te caktohet ndryshe, apo te vihet ne likujdim, vetem me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ose te Ortakut te Vetem.

Neni 5

### PERGJEGJSITE

Shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet e marra per qellime qe nuk perputhen me ato te percaktuara nga Statuti.

Shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet e marra nga ortaket ne emerin e tij personal ndaj personave te trete.

Neni 6

### OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise ekonomike i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar P S Sh.p.k. eshte: Import-eksport. Prodhim, perpunim, fraksionim i inerteve (jometalike) dhe tregtim i tyre. Transport per vehte dhe te trete brenda dhe jashte vendit ; si dhe cdo aktivitet tjeter te lejuar me ligj.

Neni 7

### KAPITALI I SHOQERISE

Vlera e pergjithshme e kapitalit te rregjistruar si Kapital Themeltar Fillestar i Shoqerise P S Sh.p.k eshte ne vleren 100 000 (njqindmije leke) me Ortake Themelues:

1. **Perparim Kurti**, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme = 100 000 leke; qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Neni 8

### TRANSFERIMI I KUOTAVE TE KAPITALIT

1. Ne rastin e transferimit te kuotave te kapitalit, ortaku qe kerkon te shese kuotat e tij te kapitalit duhet te njoftoje me shkrim administratorin, i cili njofton menjehere Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve per cmimin e shitjes se kuotave nga ortaku qe kerkon ti shese.
2. Cmimi i kuotave, oferte ne shitje duhet te vendoset ne baze te vleres reale te shoqerise ne momentin edhenies se te drejtes. Ortaket e tjera mund ti blejne ne raport me kuotat ekzistuese, duke ruajtur te njejtat raporte me kuotat qe posedon sejcili.
3. Ne qofte se brenda 30 diteve nga komunikimi i ofertes per shitje te kuotave te kapitalit te shoqerise, asnjeri nga ortaket e shoqerise nuk shprehet per blerjen e tyre, atehere, kuotat oferte shitje, mund ti transferohen cdo personi qe kerkon ti bleje.

## Neni 9

### **TRANSFERIMI TEK PJESTARI I FAMILJES**

Pjeset e kapitalit jane ligjerisht te transferueshme mes bashkeshorteve, si dhe mes paraardhesve dhe pasardhesve. Transferimi i pjeses se kapitalit mes bashkeshortesh, ne rast ndarjeje pasurie gjithashtu nuk kufizohet.

## Neni 10

### **TRANSFERIMI I KAPITALIT NE RRUGE TRASHEGIMIE OSE FALIMENTIMI**

1. Ne rast se nje ortak vdes, trashegimtari ose trashegimtaret ne rastin e bashkezoterimit te kuotave me trashegimtaret e tij, ne rast se ky person ishte zoterues ose trashegimtar i vetem i bashkezoteruesve te kuotave, do te jene personat e vetem te njohur nga shoqeria si gezues i te drejtave mbi kuoten e tij, Pavaresisht parashikimeve te ketij Statuti, pasuria e ortakut te vdekur nuk clirohet nga pergjegjesia ne lidhje me kuoten e zoteruar nga ai vetem apo se bashku me persona te tjere.
2. Personi qe fiton te drejten mbi nje kuote si pasoje e, vdekjes ose falimentimit te nje ortaku, pas paraqitjes se provave te kerkuara, administratori mund te zgjedhe te behet zoterues i kuotes ose te kerkoje rregjistrimin e kuotave ne emer te nje personi tjetër te caktuar prej tij si perfitues i kuotes. Nese personi i mesiperm zgjedh te behet zoterues i kuotes ai njofton shoqerine ne lidhje me kete zgjedhje. Nese ky person zgjedh qe nje person tjetër te rregjistrohet si zoterues i kuotes , ai kalon kuoten ne dobi te personit tjetër.
3. Personi qe fiton te drejta mbi nje kuote si pasoje e vdekjes ose falimentimit te nje ortaku, do te kete te drejta qe gezonte zoteruesi kuotes, duke perjashtuar te drejten e pjesmarrjes ose te votes ne cdo mbledhje te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve deri ne momentin e rregjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

## Neni 11

### **FORMA E TRANSFERIMIT TE PJESEVE TE KAPITALIT**

1. Kontrata per transferimin e pjeses se kapitalit duhet te jete ne formen e aktit noterial, dhe, ne rast se pronari i ri nuk eshte ortak i shoqerise, duhet te deklaroje shprehimisht ne kontrate se eshte njohur me Aktin e themelimit te shoqerise dhe Statutin e shoqerise dhe se eshte dakord me to. Kjo kontrate do te dergohet ne seline e shoqerise.
2. Administrator, mund te refuzoje rregjistrimin e kalimit te kuotes ne QKB, ne rast se kjo kuote nuk eshte shlyer plotesisht ose ne rast se Administratori, nuk eshte dakord me personin te cilit i kalon kuota.



3. Nëse administratori, apo administratorët refuzojnë të regjistrojnë kalimin e kuotës, ata njoftojnë për mospranimin e personit të cilit i kalon kuota, brenda një muaji nga dita në të cilën është paraqitur në shoqëri kërkesa për regjistrimin e kalimit të kuotës.

#### Neni 12

### ZMADHIMI I KAPITALIT

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të rrisë pa kufi kapitalin shoqërisë, në çdo moment, dhe një ose disa here, me votim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve votues prezent apo përfaqësues sipas ligjit. Mbas miratimit të pasqyrave financiare të vitit paraardhës, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, vendos për fitimet e realizuara. Asambleja mund të vendosë, që, këto fitime të zmadhojnë kapitalin e regjistruar, të rrisë rezervat statutores ose të shpërndajë dividend.

Në asnjë rast nuk mund të rritet kapitali i shoqërisë, pa mbuluar me parë humbjet e trashëguara në pasqyrat financiare. Në të gjitha rastet ndryshimet në kapital pasqyrohen në pjesët e ortakëve në mënyrë proporcionale që janë deklaruar.

Në përputhje me nenin 77 të ligjit nr. 9901, pas të vendoset shpërndaja e dividendit, administratori lëshon certifikate të aftësisë paguese. Kjo certifikatë lëshohet, vetëm nëse pas pagimit të dividendit, aktivet e shoqërisë i mbulojnë tërësisht detyrimet e saj dhe se shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që behen të kerkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

Administratori njofton për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

#### Neni 13

### KRIJIMI I REZERVAVE

Mbas miratimit të pasqyrave financiare, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve krijon rezervë statutores. Rezervë statutores duhet të jetë për çdo vit jo më pak se 10% e fitimit vjetor. Kur këto rezervë të kapin shumën e 10% të kapitalit themeltar mund të mos krijojë më rezervë.



## Neni 14

### ZVOGELIMI I KAPITALIT THEMELTAR

1. Kapitali themeltar mund te zvogelohet me Vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve.
2. Ne cdo rast kapitali themeltar nuk mund te zvogelohet nen kufinjte e percaktuar me ligj.
3. Zvogelimi i kapitalit te shoqerise perballohet nga secili ortak ne menyre proporcionale sipas kuotave qe zoterojne, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve, mund te vendose zvogelimin e kapitalit te shoqerise brenda limiteve te ligjit , qofte edhe nepermjet ortakut te vetem, apo grupe ortakesh, aktivitetesh te shoqerise apo aksioneve ose kuotave te shoqerine te tjera ne te cilat shoqeria ben pjese.
4. Vendimi per zvogelimin e kapitalit njoftohet per rregjistrim ne Qendren Kombetare te Biznesit, nepermjet Administratorit

## Neni 15

### PERFAQESIMI I SHOQERISE

1. Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve.
2. Administratori.

## Neni 16

### ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

Organi vendimor i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar P S Sh.p.k. eshte Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve.

Vendimet e saj me shumice pengojne ortaket qe mungojne apo te papajtueshem , pervec rasteve te se drejtes se tyre te kundershimit te ushtruar ne raste, afate apo forma te parashikuara ne ligj.

Gjate kohes qe shoqeria do te kete nje ortak te vetem, te drejtat dhe detyrimet e asamblese se pergjithshme ushtrohen nga Ortaku i Vetem. Te gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve apo Ortaku i Vetem rregjistrohen ne iredjistrin e vtindimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen.

Asambleja eshte organi me i larte vendimor i shoqerise i cili , e cila, eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine lidhur me ceshtjet e aktivitetit te shoqerise dhe vendos per:

- Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.
- Ndryshimin e statutit.
- Emerimin dhe largimin e administratorit
- Emerimin dhe largimin e likujdvesve dhe ekspertit kontabel te autorizuar.

- Percaktimin e shperblimeve per personat e emeruar likujdatore, ekspert, perfaqesues ne gjykate etj.
- Miratimin e bilancit vjetor, ndarjen e fitimit dhe miinyien e ndarjes se humbjeve te shoqerise.
- Zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themeltar.
- Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- Riorganiziniin dhe Prishjen e shoqerise.
- Ceshtje te tjera te parashikuara me ligj, te cilat ky statut i ie ne kompetence te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve.

#### Neni 17

#### **MBLEDHJA E ASAMBLESE DHE VOTIMI**

1. Asambleja e pergjithshme mblidhet ne rastet e percaktuara nga ligji 9901 dt. 14.04.2008, ne rastet e parashikuara ne statut dhe sa here qe mbledhja eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise. Mbledhja e zakonshme e asamblese se pergjithshme thirret te pakten nje here ne vit.
2. Asambleja e pergjithshme thirret nga administratoret apo ortaket e percaktuar sipas Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare" (i ndryshuar).
3. Asambleja e pergjithshme thirret nese, sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
4. Asambleja e pergjithshme thirret kur shoqeria propozon te shese ose te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5 perqind te, aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
5. Asambleja e pergjithshme thirret kur shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 % te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
6. Ne rastet e parashikuara ne pikat 3 e 5 te ketij neni, asamblese se pergjithshme i paraqitet nje raport nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i pavarur.
7. Dispozitat e pikes 6 te ketij neni nuk zbatohen nese blerjet, sipas pikave 4 e 5 te ketij neni, kryhen ne burse ose jane pjese e veprimeve te perditshme te shoqerise dhe behen ne kushte normale tregu. Gjithashtu, keto dispozita nuk zbulohen ne rastin kur shoqeria zoterohet nga nje ortak i vetem.
8. Ne rastet e parashikuara ne pikat 3 deri ne 5, te ketij neni, asambleja e pergjithshme mund te miratoje nje rezolute keshilluese, duke miratuar apo bere verejtje per veprimtarine e administratoreve.



9. Vendimet ne mbledhjen e asamblese ose pas konsultimit me shkrim merren nga nje ose disa ortake qe perfaqesojne me shume se tre te katertat e kapitalit themeltar. Ky numer votash mjafton edhe per ndryshimin e statutit te shoqerise.
10. Te gjitha vendimet e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, rregjistrohen ne proces verbal dhe administratoret jane pergjegjes per ruajtjen e kopjove te tyre.

#### Neni 18

#### TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKEVE

1. Ortaku ka te drejte te informohet lidhur me administrimin e shoqerise, te njihen me bilancin vjetor dhe te kerkoje me shkrim sqarime te cilat i jep administratori i mbledhjes se asamblese.
2. Secili nga ortaket ka te drejte t'i kerkoje gjykates qe te heqe nga funksioni administratorin i cili ka shkelur ligjin.
3. Secili nga ortaket ka te drejte t'i paraqese me shkrim dy here ne vit administratorit pyetje lidhur me problemet, egzistenca e te cileve ve ne dyshim vazhdimesine e aktivitetit te shoqerise. Lidhur me pergjigjen e administratorit vihen ne dijeni edhe Eksperti Kontabel i Autorizuar.
4. Ne rast se shoqeria nuk ka Ekspert Kontabel te Autorizuar, atehere emertimi i nje eksperti kontabel te autorizuar mund te kerkohet ne rruge gjyqesore nga nje ose disa ortake, pjeset e kapitalit te te cileve perfaqesojne te pakten 5% e kapitalit themeltar.
5. Nje nga disa ortake, pjesa e kapitalit te te cileve se bashku perfaqesojne 5% e kapitalit themeltar, mund te kerkojne ne rruge gjyqesore caktimin e nje ose disa eksperteve te ngarkuar per paraqitjen e nje raporti per nje apo disa veprimtari administrative. Raporti i ekspertit i dorezohet ortakut/ortakeve qe ka bere kerkesen, administratorit, eventualisht eksperteve kontabel te autorizuar, ne qofte se jane emeruar, raporti paraqitet ne mbledhjen e ardhshme te asamblese.
6. Ortaku nuk mund te marre hua nga shoqeria, te miratoje ne emer te shoqerise paradheniet ose te behet garant per detyrimet ndaj personave te trete. Ne rast te kundert veprimi eshte i pavlefshem, kjo vlen edhe per perfaqesuesit ligjore te tij, bashkeshortin si dhe paseardhesit e tij.
7. Ortaku qe eshte person juridik, eshte i detyruar qe menjehere te njoftoje ortaket e tjere lidhur me ndryshimet e statutit ose te perberjes se organeve te shoqerise se tij.
8. Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete.
9. Administratoret e shoqerise nuk mund te veprojne si perfaqesues te ortakeve ne asamblene e pergjithshme.



## NENI 19

### ADMINISTRATORES

Shoqeria perfaqesohet nga administratori.

Ne emer te shoqerise firmos administratori i cili bashkengjit emertimin tregtar te shoqerise, emer in embiemerin dhe funksionin e tij.

## NENI 20

### EMERIMI I ADMINISTRATORIT

Administratori i shoqerise P S Sh.p.k. do te jete nje ose me shume persona qe te emerohen nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve me shumicen e zakonshme te votave te ortakeve ose Ortakut te Vetem. Administratori emerohet per nje alat pese vjecar me te drejte perseritje

Administratori i shoqerise do te jete **z. Perparim Kurti** dt.lindje 27.01.1976, idendifikuar me karte identiteti nr. H60127093I, per nje afat 5 vjecar me te drejte perseritje.

Administratori mund te jete ortak ne shoqeri ose jo.

Asambleja e Piirgjithshme Ortakeve mund te shkarkoje ate ne cdo kohe me shumice te zakonshme.

## NENI 21

### KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

1. Administratori ka te drejte te veproje ne emer te shoqerise ne marredhenie me persona te trete persa i perket te gjitha ceshtjeve me perjashtim te atyre qe ligji ose ky statut i le ne kompetence te asamblese.
2. Administratori ka per detyre ne kuadrin e kompetencave te tij te siguroje mbajtjen e rregullt te evidencesdhellogarise sipasligjit, te mbaje listene tegjithe ortakeve dheteinformojeortaket lidhur me ceshtjet qe i takojne shoqerise.
3. Pergadit dhe nenshkruan bilancin vjetor dhe raportet per ecurin ti e shoqerise dhe se bashku me propozimet per shperndajen e fitimeve, i paraqet para asamblese se pergjithshme per miratim;
4. Paralajmeron ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise ;
5. Kryen rregjistrimet dhe dergon te dhenat e detyrueshme te shoqerise , sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Biznesit;
6. Raporton perpara Asamblese se Pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe ne realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise.





7. Administratori është i detyruar të therrase Asamblenë e, Pergjithshme në rastet kur:
  - Sipas bilancit vjetor apo raportet e tregtareve financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rrezikime të aktivitetit shoqëror nuk i mbulojnë detyrimet e kërkuar brenda 3 muajve në vazhdim.
  - Kur kërkohet shitja apo disponimi i aktiveve në një mënyrë tjetër me një vlerë më të lartë se 5% e asetëve të shoqërisë të vlerësuar në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.
8. Administratori ka për detyrë të përcaktojë stafin drejtues dhe të pajtojë punëmarres në shoqëri në funksionet që ai i sheh të arsyeshme .
9. Nënshkruan kontratat e punës me punëmarresit.
10. Kryen detyra të tjera të përcaktuara në këtë statut.

## NENI 22

### PERGJEGJESITË E ADMINISTRATORIT

1. Administratori i shoqërisë është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkeljet e ligjeve, për shkeljet e statutit, apo për fajet e ktyera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasoja të marreveshjeve të pamiratuara nga asambleja, që i sjellin dem shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marreveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rasteve pasojat përkatëse.
2. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas nenëve 14, 15, 17, e 18 të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar)
3. Administratori nuk mund të marrë hua nga shoqëria, të miratojë në emër të shoqërisë paratë ose të bëjë garanti për detyrimet ndaj personave të tretë. Në rast të kundërt veprimi është i pavlefshëm, kjo vlerë edhe për përfaqësuesit e tij ligjorë, bashkëshortin si edhe paraardhësit apo pasardhësit e tij.
4. Administratori ka detyrë që të pakten një herë në vit t’i paraqesë asamblese raportin mbi aktivitetin e shoqërisë dhe gjendjen e pasurisë së tij.
5. Administratori për gatit dhe i paraqet asamblese raportin lidhur me marreveshjen mes atij ose një ortakut dhe shoqërisë. Ortaku që është pale e marreveshjes rëndë mund të votojë në mbledhjen e asamblese. Administratori ose ortakut qenëshkruajnë një marreveshje pamiratim në asamblese i përgjigjen shoqërisë për demin e shkaktuar si pasojë e kësaj marreveshjeje.
6. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet shoqërore tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.



## NENI 23

### **USHTRIMI VJETOR , PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE**

1. Viti ushtrimor i aktivitetit te shoqerise mbyllet me 'daten 31 Dhjetor. Ne fund te vitit ushtrimor administratori procedon me hartimin e bilancit me llogaritjen e fitimit dhe humbjes sipas normave te ligjit, duke e shoqeruar me nje relacion shtese per aktivitetin e shoqerise.

## NENI 24

### **NDARJA E FITIMIT**

Pas plotesimit te parashikimeve te nenit 77 te ligjit 9901 date 18.04.2008 "Per Tregtaret dhe shoqerive tregtare" ( i ndryshuar), shoqeria me shumice te kualifikuar te votave te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve ose ortakut te vetem te saj, mund te deklaroje shperndarjen e dividendeve ne perputhje me te drejtat perkatese te ortakëve.

Fitimet neto qe rezultojne nga bilanci vjetor, reduktuar me 5% te destinuar per rezerven ligjore, qe arrihet deri ne 10 % te kapitalit te shoqerise, si edhe reduktimet eventuale te percaktuara nga Asambleja, shperndahen ndermjet ortakëve ne raport me kuotat e kapitalit qe zoteron secili.

## NENI 25

### **ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE**

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te dalin gjate kohes se ushtrimit te veprimtarise se shoqerise nga interpretimi, zbatimi dhe zgjidhja e Aktit te Themelimit dhe Statutit te shoqerise si dhe ne pergjithesi te gjitha mosmarreveshjet e ortakëve, apo midis nje ortakut dhe shoqerise, ne parim do te zgjidhen me mirekuptim ne baze te aktit te Akt-themelimit dhe Statutit, ne mungese te mirekuptimit zgjidhja i besohet Gjykates Shqiptare kompetente ne Rrethin Gjyqesor perkates.

## NENI 26

### **PRISHJA DHE LIKUJDIMI**

Shoqeria shperbehet :

- Ditari e shenuar ne rregjistrin tregtar ne Qendren Kombetare te Biznesit.
- Diten e shenuar ne Vendimin e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve per prishjen eshoqerise.
- Me hapjen e procedurave te falimentimit
- Ne raste te tjera te parashikuara ne ligj.



NENI 27

GJUHA

Ky statut dhe cdo dokument tjetër zyrtar paraqiten në gjuhën shqipe.

NENI 28

### **BAZA LIGJORE**

Përsa nuk është shprehur në këtë statut, është kompetencë e Asamblesë së Ortakëve ose Ortakut të vetëm, që të bëjë plotësimin e dispozitave të këtij statuti, si dhe shfuqizimin e atyre dispozitave të cilat behen të pavleshme dhe jo efektive.

Ndryshimet do të behen me Vendim të Asamblesë Ortakëve, në përputhje të plotë me dispozitat e legjislacionit shqiptar, dhe depozitohen në QKB.

**Ortak Themelues:**

**Perparim Kurti**

*Perparim Kurti*  
